

LIGJ
Nr.8217, datë 13.5.1997

**PËR NJË NDRYSHIM NË LIGJIN NR.7748, DATË 29.7.1993 "PËR STATUSIN E ISH-TË
DËNUARVE DHE TË PËRNDJEKURVE POLITIKE NGA SISTEMI KOMUNIST",
NDRYSHUAR ME LIGJIN NR.7771, DATË 7.12.1993**

Në mbështetje të nenit 23 të ligjit nr.7491, datë 29.4.1991 "Për dispozitat kryesore kushtetuese", me propozimin e një grupi deputetësh

KUVENDI POPULLOR
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1

Neni 10 i ligjit nr.7748, datë 29.7.1993 "Për statusin e ish-të dënuarve dhe të përndjekurve politikë nga sistemi komunist", ndryshuar me ligjin nr.7771, datë 7.12.1993, ndryshohet si vijon:

Procesi i regjistrimeve për njohjen e të drejtës së statusit do të vazhdojë deri më 31.12.1997, pas këtij afati nuk do të pranohen më kërkesa, përveç rasteve të pamundësisë së plotë të vërtetuar me vendim gjykatë.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi menjëherë.

Shpallur me dekretin nr.1797, datë 21.5.1997 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Sali Berisha